



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
FIER

RAPORTI VJETOR I PUNËS

PROKURORIA FIER

VITI 2017

NE VEND TE HYRJES

E nderuar znj. Prokurore e Pergjithshme!

Ne permbushje te detyrimeve ligjore, neni 50 i ligjit nr.97/2016 “Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorise se Republikes se Shqiperise” dhe Urdherit te Prokurorit te Pergjithshem nr.330, date 29.12.2016 “Per permbajtjen e raportit vjetor te drejtuesit te prokurorise”, paraqitet perpara Prokurorit te Pergjithshem te Republikes se Shqiperise raporti vjetor i punes ne Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare Fier, ku pasqyrohen treguesit e punes per nje periudhe njevjecare, per vitin 2017.

Prokuroret dhe Oficeret e Policise Gjyqesore ne Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare Fier, gjate ketij viti, kane ushtruar funksionet e tyre ne respektim te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, Marreveshjeve Nderkombetare te ratifikuara nga Republika e Shqiperise, Ligeje procedurale dhe materiale ne fuqi, duke patur prioritet respektimin e te Drejtave te Njeriut. Po keshtu nga kjo trupe eshte vepruar ne respektim te Maredhenieve nderinstitucionale, ne respektim te Kodit te Etikes, si dhe Urdherave dhe Udhezimeve te Prokurorit te Pergjithshem, duke u angazhuar ne kryerjen me sa me shume profesionalizem dhe efikasitet te funksioneve te tyre.

Viti 2017 ishte viti kur filluan te zbatohen ndryshimet thelbesore te bera ne Kodin e Procedures Penale, ne kuader te reformes ligjore ne drejtesine shqiptare, ne fushen penale, duke u futur ne zbatim institute te reja, te paaplikuara me pare, si gjyqtari i hetimeve paraprake, apo gjykimi ne seance paraprake, gjykimi me marreveshje, urdheri penal etj. Nga ana e trupes se prokuroreve eshte bere perpjekje per nje perfaqesim sa me cilesor te prokurorit ne keto gjykime.

Organizimi dhe funksionimi i Prokurorise Fier gjate periudhes se fundit te ketij viti eshte bere ne perputhje me parashikimet e ligjit nr.97, date 06.10.2016, “Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorise se Republikes se Shqiperise”, duke mbajtur ne konsiderate rregullimet e reja mbi pavaresine e prokurorit ne procesin penal.

Ngarkesa qe kane perballuar ne pune per kete vit, treguesit e shenuar ne te gjitha drejtimet, lidhur me ndjekjen penale dhe perfaqesimin ne gjykim, venien ne ekzekutim te vendimeve gjyqesore, mbikqyrjen e ekzekutimit te vendimeve penale, si dhe ushtrimin e detyrave te tjera te ngarkuara me ligj, flasin per pune me ndjenje pergjegjesie, nga te gjitha prokuroret, oficeret e policise gjyqesore dhe administrata e kesaj prokurorie. Ka patur nje bashkepunim te frytshem me te gjitha subjektet e procedimit penal.

Qellimi kryesor i analizes vjetore te punes, sikurse parashtrohet ne vijim, eshte qe te evidentojte te gjitha momentet pozitive dhe te metat ne punen e Prokurorise Fier per periudhen 1 vjecare qe lame pas, ne menyre qe ne vitin ne vazhdim te permiresohen keto tregues, duke vleresuar dhe aspiruar per rezultate edhe me te mira.

PERMBAJTJA E RAPORTIT VJETOR

I. DREJTIMET DHE PERPARESITE NE LUFTEN KUNDER KRIMINALITETIT:

- Respektimi i te drejtave te njeriut;
- Te miturit dhe grupet vulnerabel, si te pandehur dhe viktima.
- Bashkepunimi nderinstitucional.
- Bashkepunimin nderkombetar.
- Perdorimin e metodave speciale hetimore dhe hetimet proaktive.
- Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve te Keshillit te Ministrave dhe udhezimeve te Prokurorit te Pergjithshem te nxjerra ne baze te tyre.
- Informacion statistikor mbi ceshtjet penale qe lidhen me procesin e verifikimit te Integritetit te Personave qe Zgjidhen, Emerohen ose Ushtrrojne Funkcione Publike.
- Problematikat e hasura.

II. ANALIZA E TREGUESVE TE KRIMINALITETIT DHE PUNES SE PROKURORISE:

- Volumi i punes ne hetim.
- Te dhena ne lidhje me njoftimet per veprat penale.
- Treguesit kryesor te punes se prokurorise.
- Te dhena ne lidhje me masat e sigurimit.
- Ceshtje te perfaqesuara ne gjykate.
- Treguesit e ekzekutimit te vendimeve gjyqesore te formes se prere.
- Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale te njesive administrative ne kompetence te prokurorise.
- Kriminaliteti sipas peshes/perhapjes se veprave penale dhe tendencave te tyre dhe kriminaliteti sipas struktures se Kodit Penal (krime - kundervajtje).

III. TREGUESIT STATISTIKORE 2 VJEÇAR TE VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURES SE KODIT PENAL:

IV. ANALIZA E TREGUESVE TE EFEKTIVITETIT TE PUNES SE PROKURORISE:

- Treguesi i efektivitetit ne gjykimin dhe ne denimin e te pandehurve.
- Te dhena per gjykimet e posaqme.
- Te dhena mbi llojet dhe masat e denimeve.

- Te dhena sociale dhe demografike per te pandehurit.
- Te dhena per te pandehurit e mitur.

V. TE DHENA LIDHUR ME MARREDHENIET JURIDIKSIONALE ME
AUTORITETET E HUAJA:

- Ekstradime.
- Leterporosite.
- Njohjet e vendimeve penale.
- Transferimet e procedimeve penale (transferimet e procedimeve nga jashte, transferimet e procedimeve per jashte).
- Transferimet e personave te denuar.
- Shpalljet ne kerkim nderkombetar dhe heqjet nga kerkimi.

VI. TE DHENA PER NGARKESEN E PUNES:

VII. INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISE:

- Zbatimi i buxhetit, marredheniet me median dhe publikun, etj.

VIII. DREJTIMET DHE PERPARESITE NE LUFTEN KUNDER KRIMINALITETIT
PER VITIN 2018 DHE REKOMANDIME.

I. DREJTIMET DHE PERPARESITE NE LUFTEN KUNDER KRIMINALITETIT PER VITIN 2017

- **RESPEKTIMI TE DREJTAVE TE NJERIUT**

Gjate ushtrimit te funksioneve te tyre Prokuroret dhe Oficeret e policise gjyqesore ne Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare Fier i kane kushtuar nje rendesi te vecante garantimit dhe respektimit te te drejtave te njeriut, duke respektuar garancite proceduriale te personave nen hetim dhe te pandehurve, viktimes se vepres penale dhe personave te perfshire ne proces penal. Gjate kryerjes se punes se tyre kane respektuar Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Konventen per te Drejtat Themelore te Njeriut, si dhe ligje te tjera qe garantojne keto te drejta. Gjate ketij viti nuk ka patur apo jane evidentuar raste te shkeljes apo cenimit te ketyre te drejtave.

Gjate te gjithave fazave te procesit penal, eshte jane respektuar te gjitha detyrimet proceduriale dhe ato qe kane lidhje me te drejtat e njeriut.

- **TE MITURIT DHE GRUPET VULNERABEL, SI TE PANDEHUR DHE VIKTIMA**

Ne Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare Fier, per vitin 2017, nuk ka patur Seksion per te Miturit. Parashikimet e Kodit te Procedures Penale, (Urdherat dhe Udhezimet e prokurorit te Pergjithshem) perpara ndryshimeve, per hetimin e veprave penale qe lidhen me te miturit, benin kompetente Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare Vlore. Ky Seksion per te Miturit ishte kompetent edhe per procedimet penale ku i demtuar ishte nje person i mitur.

Ne lidhje me grupet vulnerabel, rastet kane qene te pakta, ku kryesisht viktimat kane qene femije, duke krijuar asistence ligjore dhe me psikolog.

- **RAPORTET ME INSTITUCIONET E TJERA**

Pergjate gjithë vitit 2017, me qellim permbushjen e veprimtarise dhe funksioneve te prokurorise, jane mbajtur raporte korrekte me institucione dhe struktura ligjzbatuese, me te cilat lidhet ngushte puna e prokurorise, ne zbatim te ligjit procedural penal dhe ligjit organik per prokurorine.

Nder keto marredhenie rolin kryesor e zene ato maredhenie qe lidhen me :

- Prokurorine e Pergjithshme, (te gjitha drejtorite);
- Strukturat e Policise se Shtetit dhe institucionet e tjera qe kane sherbime te policise gjyqesore, ku bashkepunimi konsiston ne fazen e hetimit paraprak;

- Me Gjykatën e Shkallës së Parë Fier, për fazën që lidhet me përfaqësimin e akuzës në gjykim;
- Me Prokurorinë dhe Gjykatën e Apelit Vlorë, për fazën që lidhet me përfaqësimin e akuzës në çështjet e ankimuar,
- Me institucione të tjera në nivel lokal.

- **RAPORTET ME PROKURORINË E PËRGJITHSHME.**

Gjatë vitit 2017 ka patur një raport shumë të ngushtë bashkëpunimi me të gjitha drejtoritë dhe sektorët e Prokurorisë së Përgjithshme. Ky bashkëpunim i ka shërbyer përmirësimit të treguesve të parametrave proceduriale të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Ky bashkëpunim është i lidhur drejtëpërdrejt me interesimin dhe mbështetjen e Prokurorit të Përgjithshëm, por jo vetëm. Nga ana tjetër një gatishmëri e plotë për bashkëpunimin dhe ndihmë ndaj Prokurorisë Fier është treguar edhe nga strukturat e tjera të Prokurorisë së Përgjithshme, si Kabineti, Drejtoria e Hetimit dhe Përfaqësimit në Gjykim, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, Drejtoria e Përgjimeve të Telekomunikimeve dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informatore, Drejtoria Ekonomike etj.

- **RAPORTET ME STRUKTURAT E POLICISË SË SHËTËTIT.**

Gjatë vitit 2017, përveç respektimit të rigorozitetit të detyrimeve ligjore dhe në funksion të rritjes së cilësive të hetimit paraprak, është synuar edhe krijimi i një raporti të ngushtë bashkëpunimi me të gjitha strukturat e policisë së shëttit, që veprojnë në qarkun e Fierit, si Drejtoria e Policisë së Qarkut Fier dhe Komisaritetin e Policive, në rrethet Fier dhe Mallakastër, si dhe Stacionet e Policive, rajonale.

Gjatë këtij viti, nga pikepamja formale, janë respektuar detyrimet ligjore, kur për procedimet penale që janë regjistruar mbi bazën e materialit të referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore, hetimi prej prokurorëve të ngarkuar me hetimin është deleguar tek oficeret e policisë gjyqësore, të shërbimeve perkatese dhe në disa raste (kur ka patur levizje të oficerëve të policisë) janë ngarkuar edhe oficeret e policisë gjyqësore të Seksionit të Prokurorisë si dhe katër oficerë të D.P.Q. Fier dhe një i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier, të atashuar pranë kësaj prokurorie.

Lidhur me cilësinë e hetimit paraprak, vlerësimi ynë është se është rritur niveli i hetimeve paraprake të kryera nga shërbimet e policisë gjyqësore dhe është rritur përgjegjshmëria e oficerëve të policisë gjyqësore, në raport me procedimin penal që u delegohet për hetim.

Rritjes së cilësive të hetimit paraprak i ka shërbyer edhe institucionalizimi i takimeve të përbashkëta periodike ndërmjet drejtuesve të kësaj Prokurorie dhe drejtuesve të policisë në Qarkun e Fierit.

Per te gjitha seksionet e policise gjyqesore, te krijuara ne struktura jashte kesaj Prokurorie, jemi perpjekur te japim gjithë ndihmen e mundshme, ne menyre qe te mundesojme kryerjen e detyres se tyre ne kushte sa me te mira. Kjo fryme bashkepunimi eshte e nevojshme ne kuader te luftes ndaj kriminalitetit ne vend.

- **RAPORTET ME GJYKATEN E SHKALLES SE PARE FIER**

Raportet me Gjykatën e Shkalles se Pare Fier kane qene korrekte dhe ligjore, si ne perfaqesimin e akuzes ne gjyq, ne kerkesat qe lidhen me fazen e hetimit paraprak dhe ate te gjykimit te procedimeve penale, po ashtu dhe ne gjykimet ku objekt jane kerkesat ne fazen e ekzekutimit te vendimeve penale. Prokuroreve ju eshte kerkuar respektimi me korrektese i pjesemarrjes se tyre ne gjykim dhe nga ana e tyre pjesemarrjet kane qene korrekte, me perjashtim te seancave gjyqesore, te cilat kane patur perplasje ne orar. Nga ana e gjykates eshte konstatuar angazhim i plote per mbarevajtjen e gjykimeve, respektimin e solemnitetit te tij, arsyetimit dhe depozitimit te vendimit gjyqesor.

Ka patur nje bashkepunim te mire, jo vetem me Institutcionin, por edhe me Kryetarin e Gjykates e Gjykates se Shkalles se Pare Fier ne rastet e trajtimit dhe pemirosimit te problematikave qe hasen ne punen e perditshme.

- **RAPORTET ME PROKURORINE E APELIT VLORE.**

Me Prokurorine e Apelit Vlore ka patur nje komunikim te vazhdueshem dhe shume te ngushte si dhe me pare, ne funksion te perfaqesimit sa me cilesor te akuzes ne ceshtjet e ankimuar. Ky bashkepunim, ne respektim te percaktimeve procedurale dhe udhezimit perkates te Prokurorit te Pergjithshem eshte shtrire ne diskutimin e ceshtjeve te perfaqesuara nga prokuroret e apelit. Si rezultat i nje komunikimi te tille eshte bere e mundur qe te zgjidhen plotesisht edhe disa problematika qe haseshin ne raportet mes ketyre zyrave, lidhur me perfaqesimin e akuzes ne ceshtjet e ankimuar.

Nga ana jone eshte vazhduar ndjekja e praktikës qe apelimet e prokuroreve te shkalles se pare, si per masat e sigurimit dhe per vendimet perfundimtare, krahas depozitimit ne gjykate dergohen paralelisht per njoftim edhe ne Prokurorine e Apelit, po ashtu edhe njoftimi qe Prokuroria e Apelit i dergon kesaj zyre per vendimet perfundimtare ne shkallen e dyte te gjykimit, per cdo tremujor.

Ne funksion te ketij qellimi eshte edhe organizimi i takimeve periodike, nga Drejtuesi i Prokurorisë se Apelit dhe prokuroret e kesaj prokurorie, me Drejtuesin dhe prokuroret e Prokurorisë prane Gjykates se Shkalles se Pare Fier, per njohjen dhe trajtimin e problemeve te hasura ne ceshtjet e ankimuar.

- **RAPORTET ME GJYKATEN E APELIT VLORE.**

Raportet e Prokurorisë Fier me Gjykatën e Apelit Vlore kanë qenë tepër të kufizuara, pasi përfaqësimi i akuzës në Gjykatën e Apelit është kryer nga Prokurorët në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlore.

- **RAPORTET ME INSTITUCIONET E TJERA VENDORE.**

Është bashkëpunuar me institucione si Prefektura Fier, Bashkitë e Qarkut të Fierit (Fier, Ballsh, Roskovec, Patos), në aktivitete që i shërbejnë parandalimit të përhapjes së veprave penale, sikurse janë ato në fushën e kultivimit dhe shpërdarjes së lendeve narkotike, dhunes në familje etj.

- **BASHKËPUNIMI NDERKOMBËTAR**

Në vijimesi kjo prokurori ka mbajtur një komunikim të vazhdueshëm me Drejtorinë e Marendhieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, në lidhje me lehtëporosi të mbërritura nga jashtë shtetit dhe të nisura për jashtë shtetit. Për vitin 2017, në kuadër të një procedimi penal, ku hetohej për veprën penale “Mashttrim kompjuterik”, parashikuar nga neni 143/b i Kodit Penal, janë kryer hetime në bashkëpunim me Autoritetet Gjyqësore Suedeze.

- **PERDORIMI I METODAVE SPECIALE TE HETIMIT DHE HETIMET PROAKTIVE.**

Në luftën kundër kriminalitetit, organi i prokurorisë është angazhuar maksimalisht në përdorimin e metodave speciale hetimore dhe në ndërmarrjen e hetimeve proaktive, duke bashkëpunuar me të gjithë institucionet e tjera ligjzbatuese.

Jane përdorur metoda speciale të hetimit, kryesisht përgjimi, për hetimin e veprave penale kundër korrupsionit si dhe për hetimin e krimeve kundër jetës, të kryera me dashje.

- **INFORMACION MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TE KESHILLIT TE MINISTRAVE DHE UDHEZIMEVE TE PROKURORIT TE PERGJITHSHEM TE NXJERRA NE BAZE TE TYRE.**

Gjatë këtij viti, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, që në fillimin e ushtrimit të ndjekjes penale, deri në fazën e gjyqimit, si dhe të venies në ekzekutim të vendimeve gjyqësore, kanë zbatuar me korrektesë rekomandimet e Keshillit të Ministrave, në luftën kundër kriminalitetit. Po kështu kanë vepruar në përputhje të plote me Udhezimet e Prokurorit të Përgjithshëm. Jane

vleresuar drejt kushtet dhe kriteret e vendosjes se masave te sigurimit, kerkesat per masat e denimit ne gjykim, ne perputhje me keto rekomandime dhe udhezimet perkatese.

- INFORMACION STATISTIKOR MBI CESHTJET PENALE QE LIDHEN ME PROCESIN E VERIFIKIMIT TE INTEGRITETIT TE PERSONAVE QE ZGJIDHEN, EMEROHEN, OSE USHTROJNE FUNKSIONE PUBLIKE.

Nga Sektori i Dekriminalizimit ne Prokurorine e Pergjithshme, kete vit jane percjell per ne Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare Fier 16 materiale, te cilat lidhen me procesin e Verifikimit te Integritetit te Personave qe Zgjidhen, Emerohen ose Ushtrojne Funkcione Publike.

Tabela e meposhtme tregon te dhenat statistikore ne lidhje me keto procedime.

Procedim i regjistruar	Neni	Te pandehur	Pushuar	Transferuar ne hetim	Derguar gjyqit	Transferuar ne gjykim	Gjykuar	Mbartur ne gjykim
16	190/1	14	1	1	14	7	4	3



Referuar grafikut te mesiperme, vihet re qe numri i procedimeve penale te regjistruara qe lidhen me procesin e verifikimit te integritetit te personave qe zgjidhen, emerohen, ose ushtrojne funksione publike eshte 1% e totalit te procedimeve penale, te regjistruara per vitin 2017.

- **PROBLEMATIKAT E HASURA**

Problematika kryesore mbetet zgjatja e afateve ne hetimin e veprave penale. Si pengese, qe ka cuar ne zgjatjen e afatit te hetimeve, dhe mos perfundimin ne kohe te nje numri te konsiderueshem te procedimeve penale, ka sherbyer ne disa raste mosimpenjimi dhe vonesa ne kryerjen e veprimeve hetimore nga policia gjyqesore. Po keshtu jo pak ndikim kane patur zevendesimet e o.p.gjyqesore, si rezultat i transferimeve (kryesisht o.p.gjyqesore te Komisariateve dhe DVP Fier, por edhe te seksioneve te tjera). Si shkak per zgjatje te hetimit ka sherbyer edhe vonesa ne mberrijten e akteve te ekspertimit kriminalistik apo pergjigjeve te kerkuara nga shoqerite e telefonise celulare.

Problematike ne vetvehte perbejne dhe referimet jo te sakta te vepres penale nga oficeret e policise gjyqesore, mosnjoftimi i prokuroreve per ngjarjet e ndodhura, marrja jo e sakte e gjeneraliteteve te subjekteve etj.

Vihet re mungese referimi per vepra penale, ku ekziston mundesia nga prokurori per te planizuar apo deleguar kryerjen e veprimeve hetimore proaktive.

Vihet re raste referimi per kryerjen e veprave penale te “Pastrimit te produkteve te vepres penale”, neni 287 i K.Penal, te paplota, pa kryer nje minimum verifikimi ne lidhje me sa referohet.

Vihet re qe prane Drejtorise Vendore te Policise ngarkohen me hetimin e veprave penale Oficere te Policise Gjyqesore, me kohe te pjeshme, ku nje pjese te kohes ato jane ne vazhdim te studimeve.

II. ANALIZA E TREGUESVE TE KRIMINALITETIT DHE TE PUNES SE PROKURORISE:

Me urdherin nr.16, date 22.02.2017, te Drejtuesit te Prokurorise Fier, bazuar ne nenin 148 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise si dhe nenet 17, 20, 21 e 42, te Ligjit nr. 97/2016 “Per Organizimin dhe Funksonimin e Prokurorise ne Republikën e Shqiperise”, ne Prokurorine Fier jane krijuar dhe funksionojne 3 Seksione: 1)Seksioni Kunder Krimet Ekonomik-Financiar, Korrupsionit dhe Krimet Kibernetik; 2) Seksioni i Ekzekutimeve te Vendimeve Penale, Marrdhenieve Juridiksionale me Jashte, Kerkesave gjate Fazes se Vuajtjes se Denimit, Perfaqesimin e Ceshtjeve me Ankim, Gjykimeve si pale e trete dhe veprave penale te

parashikuara nga Kreu i II, seksionet V, VI, VII, VIII, IX, X dhe Kreu i X; 3)Seksioni i Veprave te Tjera Penale.

1-Seksioni Kunder Krimet Ekonomik-Financiar, Korrupsionit dhe Krimet Kibernetik, perfshin veprat penale te parashikuara nga Kreu III, seksioni I, neni 135, seksioni II, nenet 143/a, 143/a/1, 143/a/2, 143/a/3, 143/a/4, 143/a/5, 143/a/6, 143/a/7, 143/b, 144, 144/a, 145, 146, 147, 148, 149, 149/a, 149/b, seksioni IV, seksioni IV/1, seksioni V, seksioni VI, seksioni VII, seksioni VIII, seksioni IX, seksioni X, Kreu VIII, seksioni I, nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 246, 246/a, seksioni II, seksioni i III, nenet 287, 287/a, 287/b, 288, 288/a, 288/b, 293/a, 293/b, 293/c, 293/?, 293/d, Kreu IX, nenet 312, 313, 313/a, 313/b, 314, 319/b, 319/dh (duke perjashtuar dispozitat penale te parashikuara nga neni 75/a te K.Pr.Penale

2-Seksioni i Ekzekutimeve, perfshin Ekzekutimin e Vendimeve Penale, Maredheniet Juridiksionale me Jashte, Kerkesat gjate Fazes se Vuajtjes se Denimit, Perfaqesimin e Ceshtjeve me Ankim, Gjykimeve si pale e trete dhe veprave penale te parashikuara nga Kreu i II, seksionet V, VI, VII, VIII, IX, X dhe Kreu i X (duke perjashtuar dispozitat penale te parashikuara nga neni 75/a).


3-Seksioni i Veprave te Tjera Penale, perfshin veprat penale te parashikuara nga Kreu II, seksioni I, II, III, IV, Kreu i III, seksioni I, nenet 134, 136, 137, 137/a, 138, 138/a, 139, 140, 141, 141/a, 142, seksioni II, neni 143, seksioni III, seksioni XI, Kreu IV, Kreu V, seksioni I, seksioni II, nenet 222 deri 225, Kreu VI, Kreu VII, Kreu VIII , seksioni I, nenet 235 deri 243 dhe neni 247, seksioni i III, nenet 261 deri 286/a, nenet 289 deri 293, seksioni IV, Kreu IX, nenet 300 deri 311, neni 312/a, nenet 316, 317, 318, 320 deri 324/a (duke perjashtuar dispozitat penale te parashikuara nga neni 75/a te K.Pr.Penale).

Prokuroret dhe oficeret e policise gjyqesore, gjate ketij viti, kane hetuar dhe perfaqesuar ne gjykim, krahas ceshtjeve penale, te cilat jane ndare dhe hedhur ne short, sipas seksioneve, (pas dates 16.02.2017), edhe ceshtje penale, ku hetohet per vepra penale qe nuk i perkisnin seksionit te tyre. Keto ceshtje penale ato i kane patur ne hetim dhe i perkasin periudhes para ndarjes se Seksioneve ne Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare Fier.



Referuar te dhenave qe do t'ju paraqesim dhe analizojme ne kete raport vjetor, evidentohet se gjate vitit 2017, Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare Fier, ka perballuar nje ngarkese pune te konsiderueshme.

Ne Prokurorine prane Gjykeses se Shkalles se Pare Fier, per vitin 2017, jane regjistruar 2188 kallelzime penale.

Kryesisht	Kallzime nga Nepunesit Publike	Kallzime nga Shtetasit	Ankime per V.P qe ndiqen mbi Ankim	Kallzime nga Policia e Shtetit	Kallzime nga Policite e Tjera
27	85	164	4	1862	46




Referuar grafikut te mesiperm, vihet re qe: 85% e kallelzimeve te regjistruara ne vitin 2017 jane referuar nga Policia e Shtetit; 8% e kallelzimeve jane bere nga shtetasit; 4% e kallelzimeve penale jane bere nga nepunesit public; 2 % e kallelzimebereve jane nga policite e tjera; si dhe 1% jane nisur kryesisht.




Referuar grafikut te mesiperm, vihet re qe 49% e kallezimeve penale, te regjistruara ne vitin 2017, jane vepra penale qe i perkasin KREUT te III -te te Kodit Penal, “Veprat penale kunder pasurise dhe ne sferen ekonomike”.

Ne vitin 2017 jane regjistruar gjithsej 1616 procedime penale, nder te cilat 26 procedime jane te ardhura me transferim nga prokurorite e tjera, nderkohe qe ne vitin 2016 ishin regjistruar 1763 procedime penale.


Theksojme se ne vitin 2017 jane regjistruar 147 procedime penale me pak se ne vitin 2016.



Ne vitin 2016 jane hetuar ne total 2167 procedime penale, ndersa ne vitin 2017 ne total jane hetuar 2150 procedime penale (nder te cilat 1616 regjistruar ne 2017, 505 procedime te mbartuara, 3 terhequr aktet dhe 26 procedime penale te rifilluara dhe te shfuqizuara).



Krahasuar me vitin 2016, vit i cili kishte te regjistruar 147 procedime penale te reja me shume se 2017, diferenca e procedimeve te hetuara gjate nje viti rezulton te jete shume e vogel me nje vit me pare, vetem 17 procedime me pak te hetuara ne vitin 2017.



Referuar grafikut te mesiperm, vihet re qe procedimet e reja ne 2017, perbejne 75% te totalit te hetuar ne vitin 2017, procedimet e mbartuara ne vitin 2017 zene 24% dhe vetem 1% jane procedimet e rifilluara/shfuqizuara.

Ne procedimet e hetuara gjate vitit 2017, eshte ushtruar ndjekja penale ndaj 1172 personave, nga keta 541 persona nen hetim dhe 631 te pandehur.

Nga ana e prokuroreve eshte treguar kujdes i veçante qysh ne momentin fillestar te hetimeve qe, nga njera ane, te mos caktohet masa e sigurimit “arrest ne burg” pa patur prova evidente per vertetimin e akuzes dhe nga ana tjetere dhe te mos merreshin persona te pandehur pa patur nje baze te mjaftueshme te te dhenave qe do te siguronin mbrojtjen e akuzes deri ne gjykim.

CESHTJE TE MOSFILLUARA

Ne vitin 2017 eshte vendosur mosfillimi per 572 kallezime, nder te cilat:

- 533 kallezime penale jane mosfilluar per faktin se eshte referuar per veper penale konkrete dhe ka rezultuar se nuk ka patur elemente te veprave penale, si dhe ne rastet e veprave penale qe ndiqen me ankim direkt ne gjykate nga te demtuarit akuzues.


- 39 kallelzime penale jane mosfilluar per faktin se kane qene kallelzime penale te cilat nuk referonin per vepra penale konkrete.

Ne te gjitha rastet kur eshte vendosur mosfillimi i procedimit penal, pervec bazueshmerise ne fakt dhe ne ligj te vendimmarrjes, dhe kohes se marrjes se saj, eshte respektuar me korrektese edhe detyrimi ligjor, per njoftimin e vendimit personave te interesuar, duke respektuar te drejten e tyre per te ushtruar ankimin ne gjykate. Nga ana e Gjykates jane shfuqizuar 8 vendime mosfillimi.

Kur nga materiali fillestar nuk kane rezultuar elemente te mjaftueshem per fillimin e ceshtjes penale, prokuroret dhe oficeret e policise gjyqesore kane kryer verifikimet paraprake (duke synuar respektimin e afatit kohor), pas te cilit, nese nuk siguroheshin te dhena te tjera, eshte vendosur mosfillimi i procedimit penal.

PROCEDIMET PENALE TE BASHKUARA


Ne vitin 2017, jane bashkuar me procedime te tjera, gjithsej 38 procedime penale.



38 procedime penale te bashkuara, perbejne 2% te totalit te procedimeve te hetuara ne vitin 2017.


PROCEDIME PENALE TE TRANSFERUARA

Gjate vitit 2017 jane transferuar gjithsej 51 procedime penale, me 43 persona nen hetim, 1 te pandehur, nder te cilet 8 persona me mase sigurimi arrest ne burg.



51 procedime penale te transferuara perbejne 2% e totalit te procedimeve te hetuara ne vitin 2017.


Theksojme se pjesen me te madhe te ketyre procedimeve penale, edhe kete vit, e zene ato per vepren penale te parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal. Me ndryshimet qe kane ndodhur ne Kodin e Procedures Penale i jane transferuar Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare Vlore, Seksionit per te Miturit edhe procedimet me te demtuar te miturit.




Nder procedimet penale te transferuara 53% te totalit e zene procedimet per vepra penale te Kreut III, Kreut II- 27%, Kreut VIII -14% dhe Kreu IX- 6%.

PROCEDIME PENALE TE PUSHUARA


Gjate vitit 2017 jane pushuar gjithsej 332 procedime penale, te cilat perbejne 16% te totalit te procedimeve te hetuara ne vitin 2017.



Nga 332 procedime te pushuara gjithsej, prej tyre 26 procedime jane pushuar per mungese fakti, 28 procedime jane pushuar per mungese te provave dhe 280 procedime jane pushuar per shkaqe te tjera procedural. Nder shkaqet e tjera me kryesoret jane ato per mungese te elementeve te vepres penale dhe heqjet dore nga te demtuarit, per veprat penale qe ndiqen me ankim.



Referuar grafikut te mesiperm, vihet re qe 8% e procedimeve penale jane pushuar per mungese fakti, 8% per mungese prove dhe 84% per shkaqe te tjera.



Veprat penale te Kreut VIII-te zene 42% te procedimeve penale te pushuara, te Kreut III - 33%, te Kreut II - 18%, te Kreut IX - 5% dhe te Kreut IV - 2%.

Me hyrjen ne fuqi te ndryshimeve te bera ne Kodin e Procedures Penale, ne Gusht te vitit 2017, ne perfundim te hetimeve paraprake, kur eshte proceduar per krime, nga ana e prokuroreve eshte vepruar me “Kerkese per pushimin e ceshtjes penale” tek gjyqtari i séances paraprake per gjithsej 89 procedime penale.


Ne asnje rast nuk eshte vendosur nga gjyqtari i séances paraprake ne Gjykatën e Shkalles se Pare Fier per kthim aktesh, per disponim per formulim akuze dhe paraqitje kerkese per gjykim.

Ne procedimet penale te pushuara :

- Eshte pushuar ndjekja penale per 275 persona nen hetim, 1 prej te cileve ka qene me mase sigurimi arrest ne burg;
- Jane pushuar hetimet per 2 te pandehur;
- Per 38 prej ketyre personave hetimet jane pushuar per mungese te provave;
- Per mungese te faktit penal jane pushuar 23 procedime;
- Per 214 procedime penale pushimi eshte bere per shkaqe te tjera

CESHTJE TE PEZULLUARA

Gjate vitit 2017, jane pezulluar gjithsej 602 procedime penale. Te gjitha keto procedime penale jane pezulluar per shkak se nuk eshte bere e mundur te zbulohet autori i vepres penale, pra e thene ndryshe jane pezulluar per zbulim autori 28% e procedimeve penale te hetuara ne 2017.



Ne vitin 2017 kemi 74 procedime penale te pezulluara, me shume se viti 2016.



Referuar statistikave, rezulton se pjesa me e madhe e procedimeve penale te pezulluara, edhe kete vit, lidhet me veprat penale kunder pasurise, pra veprat penale te Kreut III, qe ze 84% te procedimeve te pezulluara, dhe kryesisht me vepren penale te vjedhjes, ku pjesen kryesore e zene

vjedhjet e banesave apo te automjeteve te shtetasve, e ndjekur nga veprat penale te Kreut VIII, 11%, te Kreut II, 3%, te Kreut IX, 1% dhe Kreu IV, 1%.


Ritheksojme si çdo vit, qe puna e strukturave perkatese per parandalimin dhe zbulimin e kesaj vepre penale nuk eshte ne nivelin e duhur.


Eshte e domosdoshme qe per zbulimin e autoreve te ketyre veprave penale, qe perben nje shqetesim real per komunitetin qe perfshin qarku i Fierit, te gjitha strukturat policore, si ato per parandalimin dhe per hetimin e ketij krimi te organizojne nje pune te mirefillte profesionale, ku krahas perdorimit te mjeteve klasike per sigurimin e provave te perdorin edhe mjete te posacme per kerkimin e tyre.

Nga prokuroret eshte kerkuar ne vazhdimesi, qe te tregohet vemendja e duhur me qellim qe pezullimi i procedimit penal te vendosej pas kryerjes nga policia gjyqesore te gjithe veprimeve hetimore paraprake te mundshme. Pavaresisht nga sa me siper, eshte me vend te kerkohet nje vemendje me e madhe nga oficeret e policise gjyqesore, te sherbimeve dhe seksionit, gjate kryerjes se veprimeve te paperseritshme te hetimit paraprak, si kqyrja e vendit te ngjarjes, evidentimi i te gjitha gjurmeve dhe sendeve te gjetura aty, marrja e provave materiale, me qellim qe numri procedimeve penale te kesaj natyre, te vije duke u zvogeluar.

PROCEDIMET PENALE TE DERGUARA PER GJYKIM

Ne vitin 2017, jane derguar per gjykim gjithsej 543 procedime penale, me 617 persona te pandehur. 25% e procedimeve penale te hetuara ne vitin 2017 jane derguar per gjykim.





Persa i perket procedimeve penale te derguara per gjykim, rreth 48% e zene procedimet penale ku hetohet per veprat penale qe perfshihen ne Kreu VIII, 31% - Kreu III, 16% - Kreu II dhe 5% - Kreu IX I K.Penal.

Persa i perket personave ne cilesine e te pandehurite cilet jane deguar ne gjyq, 159 prej tyre kane qene me mase sigurimi arrest ne burg, 13 arrest ne shtepi, 116 detyrim paraqitje, 8 pezullime nga detyra, 7 ndalime per te dale jashte shtetit, 1 qendrim ne nje vend te caktuar, 2 garanci pasurore, 5 masa mjekesore, 1 ndalim per te dale jashte shtetit.


Vlen te theksojme qe jane derguar per gjykim 5 procedime me 5 te pandehur nga procedimet e rifilluara ne vitin 2017 (nga te cilat 3 procedime te pezulluara dhe 2 procedime per te cilat eshte kerkuar revokimi i vendimi te pushimit ne Gjykate).

Me hyrjen ne fuqi te Kodit te Procedures Penale ne Gusht te vitit 2017, kur i pandehuri akuzohet per kryerjen e nje kundervajtjeje penale, nga ana e prokuroreve jane nxjerr Urdhera Penal qe jane derguar ne Gjykate per 11 procedime, dhe per 1 procedim (per nenin 182/a te K.Penal) eshte refuzuar Urdheri Penal dhe jane kther aktet. (Keto akte jane derguar perseri ne Gjykate me kerkese per gjykim).

Me hyrjen ne fuqi te Kodit te Procedures Penale ne Gusht te vitit 2017, jane derguar ne gjykate per gjykim me Marreveshje 10 procedime penale dhe per 1 procedim (per nenin 291 te K.Penal) eshte refuzuar Marreveshja dhe jane kthyer aktet. (Keto akte jane derguar perseri ne Gjykate me kerkese per gjykim).

Me hyrjen ne fuqi te Kodit te Procedures Penale ne Gusht te vitit 2017, jane derguar ne seance paraprake kerkesa per gjykim per 162 procedime penale, dhe vetem per 1 procedim penal gjykata ka vendosur Pushim Çeshtje ose akuze (per nenin 199/a/1 te K.Penal), 1 procedim penal eshte derguar ne Gjykatën Kompetente (per nenin 124/b te K.Penal) dhe jane kthyer aktet per 5 procedime penale te cilat jane riderguar me kerkese per gjykim ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Fier.

Grafiku i meposhtem tregon ne perqindje statusin e procedimeve penale te hetuara ne vitin 2017



Persa i perket procedimeve penale, rezultojne te jene perfunduar nga nje total prej 2150 procedime penale (pushimet 16%, pezullimet 28%, transferimet 2%, derguar gjyqit 25%, dhe bashkuar 2%), 1566 procedime penale, me 944 persona, nder te cilet 622 te pandehur dhe 322 persona nen hetim. Nga keta persona, jane hetuar 167 persona me masen e sigurimit “arrest ne burg”. E thene ndryshe jane perfunduar 73% e procedimeve penale te hetuara ne vitin 2017.

Sa me siper, per periudhen njevjecare, te vitit 2017 (duke perfshire mosfillimet, pushimet, pezullimet, transferimet, derguar gjyqit, dhe bashkuar), jane perfunduar gjithsej 2138 çeshtje penale.

Ne vitin 2018, Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare Fier mbart ne hetim 584 procedime penale, e thene ndryshe 27% e procedimeve penale ne hetim per vitin 2017.

- TREGUESIT E ARRESTIMEVE NE FLAGRANCE DHE NDALIMEVE

Per vitin 2017, treguesit e arrestimeve ne flagrance dhe ndalimeve, te kryer ndaj shtetasve te dyshuar per kryerjen e veprave te ndryshme penale, paraqiten si me poshte:

Jane arrestuar ne flagrance nga policia gjyqesore 274 shtetas.

Jane ndaluar nga policia gjyqesore 28 shtetas.

Eshte nxjerre urdher ndalimi nga prokurori per 3 shtetas (nje prej te cileve nuk eshte ekzekutuar dhe me pas eshte kerkuar caktim mase arrest burg ne mungese).


Per 3 persona te arrestuar ne flagrance apo te ndaluar nga policia gjyqesore, prokurori ka disponuar per lirimin e menjehershem. Per 3 persona te arrestuar nuk eshte kerkuar mase sigurimi. Nga ana e Gjykates se Shkalles se Pare Fier per 5 persona eshte vendosur qe te ndiqen penalisht ne gjendje te lire.

Eshte kerkuar ne gjykate vleresimi i arrestimit ne flagrance apo ndalimit per 305 persona, nder te cilet Gjykata ka vleresuar te ligjshem arrestimin per 298 persona dhe te paligjshem per 7 persona. Ne lidhje me vleftesimin e arrestimit te paligjshem, paligjshmeria sipas Gjykates ka konsistuar ne intepretimin e kohes se kapjes se personit, me procesverbalin e arrestimit ne flagrance.

Fakti qe vetem ne dy raste eshte vendosur lirimi i menjehershem i te arrestuarve, si dhe fakti qe arrestimet ne flagrance apo ndalimet nuk jane vleftesuar te paligjshme ne asnje rast nga prokuroret, ndersa prej Gjykates vetem ne 7 raste eshte vleftesuar arresti i paligjshem, cmojme se eshte nje tregues pozitiv ne kete drejtim.

Per vitin 2017, treguesit e kerkesave te prokurorit dhe vendimet e gjykates per masat kryesore te sigurimit, paraqiten si me poshte vijon :

Kerkesa te Prokurorit per Masa Sigurimi					Vendime te Gjykates per Masa Sigurimi				
Arrest ne Burg	Arrest ne Shtepi	Garanci Pasurore	Detyrim Paraqitje Pol. Gjyqesore	Masa te tjera	Arrest ne Burg	Arrest ne Shtepi	Garanci Pasurore	Detyrim Paraqitje Pol. Gjyqesore	Masa te tjera
209	14	3	115	13	171	23	3	142	13



- **ÇESHTJE TE PERFAQESUARA NE GJYKATE.**

Gjate ketij viti, pervec akuzes ne gjykim, jane perfaqesuar ne gjykate nje numer i konsiderueshem i ceshtjeve apo kerkesave per te cilat prokurori thirret si person i trete ose ndiqen me kerkim te drejtperdrejte ne Gjykate si dhe kerkesat e te burgosurve gjate vuajtjes se denimit ne I.E.V.P Fier. Theksojme se ky numer kete vit ka qene shume i larte duke krahasuar me vitet e meparshme. Nga 931 perfaqesime ne gjykate, 862 jane perfaqesuar nga prokuroret e Seksionit te Ekzekutimeve te Vendimeve Penale: Artur Cara ka perfaqesuar 297, Aida Cakaj ka perfaqesuar 280 dhe Ervisa Hyka ka perfaqesuar 285.

TE DHENA PER FAZEN E E EKZEKUTIMIT

Gjate vitit 2017, jane nxjerre gjithsej 1514 urdhera ekzekutimi, ne krahasim me 1140 urdhera te nxjerra ne vitin 2016. Nga keto 258 urdhera ekzekutimi kane qene me burgim, 99 urdhera ekzekutimi me gjobe, 267 urdhera ekzekutimi per pezullimin e denimit me kusht, 6 urdhera

ekzekutimi qendrim ne shtepi, 59 urdhera ekzekutimi pezullim dhe detyrimi me pune ne interes te publikut, 1 urdher ekzekutimi me detyrimin e te denuarit te vene ne prove dhe 824 urdhera ekzekutimi te ndryshem, kryesisht shpenzime procedurale, masa mjekesore dhe shuarje mase sigurimi.

Urdhra per Ekzekutim						
Burg	Gjobe	Neni 59	Neni 59/a	Neni 60	Neni 63	Shpenzime procedurale, etj
258	99	267	6	1	59	824

- KRIMINALITETI SIPAS SHTRIRJES TERRITORIALE TE NJESIVE ADMINISTRATIVE NE KOMPETENCE TE PROKURORISE.

Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare Fier e shtrin juridiksionin e saj ne 2 rrethe, ne Rrethin Fier qe perbehet nga 3 Bashki, Bashkia Fier, Patos, Roskovec dhe Rrethi Mallakaster qe perbehet nga Bashkia Ballsh.

Duke qene se Bashkia Fier ka shtrirjen me te madhe territorial, popullsine me te madhe, per rrjedhoje dhe numri i kriminalitetit eshte me i madh ne krahasim me bashkite e tjera.

- KRIMINALITETI SIPAS PESHES/PERHAPJES SE VEPRAVE PENALE DHE TENDENCAVE TE TYRE DHE KRIMINALITETI SIPAS STRUKTURES SE KODIT PENAL (KRIME - KUNDERVAJTJE).

Lidhur me gjendjen e kriminalitetit gjate vitit 2017 (theksojme qe keto te dhena jane perpunuar duke zbritur procedimet penale te bashkuara), veprat penale te cilat zene numrin me te madh te procedimeve penale te regjistruara jane veprat penale te parashikuara nga Kreu II, Kreu III dhe Kreu VIII i K.Penal.

Konkretisht:

Kreu II -te, gjithsej 210 procedime penale qe perbejne 13 % te procedimeve penale te regjistruara ne vitin 2017.



Kreu III, gjithsej 852 procedime penale qe perbejne 54% te procedimeve te regjistruara ne vitin 2017.

Kreu IV, gjithsej 7 procedime penale.

Kreu VIII, gjithsej 450 procedime penale qe perbejne 29% te procedimeve penale te regjistruara ne vitin 2017.

Kreu IX, gjithsej 59 procedime penale, qe perbejne 4% te procedimeve penale te regjistruara ne vitin 2017.

Kreu X, gjithsej 2 procedime penale.



Ne krahasim me vitin 2016, ne vitin 2017 rezulton:

Per Kreun e II-te te Kodit Penal - ne vitin 2017 eshte regjistruar 1 procedim me pak se ne vitin 2016.

Per Kreun e III-te te Kodit Penal - ne vitin 2017 rezultojne te regjistruara 70 procedime penale me shume se 2016.

Per Kreun e IV-ert te K.Penal - ne vitin 2017 eshte regjistruar 1 procedim penal me shume se ne vitin 2016.

Per Kreun e VIII-te te Kodit Penal - ne vitin 2017 jane regjistruar 235 procedime penale me pak se ne vitin 2016.

Per Kreun e IX-te te Kodit Penal - ne vitin 2017 jane regjistruar 8 procedime penale me shume se ne vitin 2016.

Kreu X-te i Kodit Penal - ne vitin 2017 jane regjistruar 2 procedime penale me shume se ne vitin 2016.

Grafiku i meposhtem tregon kriminalitetin sipas struktures se Kodit Penal, te procedimeve penale te hetuara gjate vitit 2017, ne Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare Fier.



III. TREGUESIT STATISTIKORE 2 VJECAR TE VEPRAVE PENALE.

KRIME KUNDER JETES ME DASHJE	2016					2017				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	<u>Nr. i pand. Regj</u>	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	<u>Nr. i pand. Regj</u>	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
<u>Neni 76 Vrasja</u>						2				
Neni 77 Vrasja per nje krim tjetër										
Neni 78 Vrasja me paramendim	1	1		2		4				
Neni 78/a Vrasje per gjakmarrje										
Neni 79 Vrasja ne rrethana cilesuese	2	2	1	3	4					
Neni 79/a Vrasja e funksionareve publike										
Neni 79/b Vrasja e punonjeseve te Policise se Shtetit										
Neni 79/c Vrasja per shkak te marredhenieve familjare			1			1		1		
Neni 80										
Neni 81 Vrasja e foshnje										
Neni 82 Vrasja ne tronditje psikike										
Neni 83 Ne kapercim mbrojtjes nevojshme										
Neni 83/a Kanosje per hakmarrje/gjakmarrje										
Neni 83/b Nxitja per gjakmarrje										
Neni 84 Kanosja	23	6	22	9	12	22	10	18	11	9
Totali	26	9	24	14	16	29	10	19	11	9

KRIME KUNDER JETES SHKAKTUAR ME PAKUJDESI	2016					2017				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjkim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjkim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjkim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjkim	Nr. Pand denuar
Neni 85 Vrasja nga pakujdesia										
Totali	0	1	0	1	1	0	0	0	0	0

V.P. K/SHENDETIT ME DASHJE	2016					2017				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjkim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjkim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjkim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjkim	Nr. Pand denuar
Neni 86 Tortura										
Neni 87 Tortura me pasoja te renda										
Neni 88 Plagosje e rende	6	4	4	4	3	5	3	6	3	5
Neni 88/a Plagosje e rende tronditje psikike										
Neni 88/b P.R. ne kapercim te mbrojtjes										
Neni 89 Plagosje e lehte me dashje	26	13	34	14	13					
Neni 89/a						29	7	32	9	11
Neni 90 Demtime te tjera										
Totali	32	17	38	18	16	34	10	38	12	16

VEPRA PENALE KUNDER SHENDETIT TE KRYERA NGA PAKUJDESIA	2016					2017				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjkim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjkim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjkim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjkim	Nr. Pand denuar
Neni 91 Plagosje e rende nga pakujdesia										
Neni 92 Plagosja e lehte nga pakujdesia	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

VEPRA PENALE QE RREZIKOJNE JETEN DHE SHENDETIN NGA NDERPRERJA E SHTATZANISE OSE NGA MOSDHENIA E NDIHMES	2016					2017				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 93 Nderprerja e shtatzanise pa pelqim te gruas										
Neni 94 Nderprerja e shtatzanise e kryer ne vende dhe nga persona te paautoriz.										
Neni 95 Dhenia e mjeteve per nderprerjen e shtatzanise	2		1							
Neni 96 Mjekimi i pakujdesshem						1	1		1	
Neni 97 Mosdhenia ndihme										
Neni 98 Mosdhenia e ndihmes nga kapiteni i anijes										
Neni 99 Shkaktimi i vetevrasjes	11	1	1	1	1	31	1	2	1	1
Totali	13	1	2	1	1	32	2	2	2	1

KRIME SEKSUALE	2016					2017				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 100 M. Sek/ homoseksuale me te mitur						1	1	1	2	2
Neni 101 M. Sek/ homoseksuale me dhune me te mitur te moshes me 14-18 vjeç										
Neni 102 M. Seksuale me dhune me te rritura	1	1	2	1						1
Neni 102/a M. Homoseksuale me dhune me te rritur										
Neni 103 M. Sek/ homoseksuale me persona te pazote per t'u mbrojtur										
Neni 104 Marredhenie seksuale ose homoseksualeme kerkcenim me perdorimin e armes										
Neni 105 M. Sek/ homoseksuale duke shperdoruar detyren										
Neni 106 M. Sek/ homoseksuale me persona ne gjini ose ne kujdestari										
Neni 107 M. Sek/ homoseksuale ne vende publike										
Neni 108 Vepra te turpshme	1		1			1		1		
Neni 108/a Ngacmimi Seksual	3	1	3	1	2		2	1	2	2
Totali	5	2	6	2	2	2	3	3	4	5

VEPRA PENALE KUNDER LIRISE SE PERSONIT	2016					2017				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 109 Rrembimi ose mbajtja peng e personit										
Neni 109/a Rrembimi ose mbajtja peng e personit ne rrethana lehtesuese										
Neni 109/b Shtrengimi me ane te kanosjes ose dhunes per dhenien e pasurise										
Neni 109/c Zhdukja me force										
Neni 110 Heqja e paligjshme e lirise	2	1	2	1	8	4	1	4	2	
Neni 111 Rrembimi i avioneve, anijeve dhe mjeteve te tjera										
Neni 112 Dhunimi i baneses	2	1	3	1						
Totali	4	2	5	2	8	4	1	4	2	0

VEPRA PENALE KUNDER MORALIT DHE DINJITETIT	2016					2017				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 113 Prostitucioni				15	19					
Neni 114 Shfrytezimi i prostitucionit	3	1	2	1	3	12	1	4	1	2
Neni 115 Mbajtja e lokaleve per prostitucion										
Neni 117 Pornografia						1				
Neni 118 Dhunimi i varreve	2	3	1	3	1	3				
Neni 119 Fyerja										
Neni 120 Shpifja										
Neni 121 Nderhyrje te padrejta ne jeten private						1				
Neni 121/a Perndjekja	3	4	3	4	4	6	4	5	4	
Neni 122 Perhapja e sekreteve vetjake										
Neni 123 Pengimi ose shkelja e fshehtesise se korrespondences										
Totali	8	8	6	23	27	23	5	9	5	2

VEPRA PENALE KUNDER FEMIJEVE, MARTESES DHE FAMILJES	2016					2017				
	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 124 Braktisja e femijeve te mitur	6		6			5		4		
Neni 124/b Keqtrajtimi i te miturit	2		4		1	1	1	1	1	1
Neni 125 Mosdhenia e mjeteve per jetese										
Neni 126 Mosnjoftimi i ndryshimit te vendbanimit	1		1							
Neni 127 Marrja e padrejte e femijes										
Neni 128 Nderrimi i femijeve										
Neni 128/a Fshehja ose nderrimi me dashje I femijes										
Neni 129 Shtytja e te miturve ne krim										
Neni 130 Shtrengimi ose pengimi per te bashkejetuar ose per te zgjidhur martese										
130/a Dhuna ne familje	105	85	112	92	89	75	56	76	61	51
Totali	114	85	123	92	90	81	57	81	62	52

VEPRA PENALE KUNDER LIRISE SE BESIMIT	2016					2017				
	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 131 Pengimi i veprimtarive te organizatave fetare										
